

METRO_POLIS SHPK

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETAVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 16

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	6,785,855	4,623,595
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	5,934,349	10,530,571
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,215,868	2,252,231
Total aktive afatshkurtra		14,936,072	17,406,397
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	2,518,595	342,664
Total aktive afatgjata		2,518,595	342,664
Total aktive		17,454,667	17,749,061
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	8	3,858,106	3,876,240
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	9	6,480,085	9,480,085
Detyrime tatimore	10	1,630,205	1,606,003
Të ardhurat e shtyra	11	2,068,625	-
Të tjera detyrime	12	742,111	307,258
Total detyrime afatshkurtra		14,779,132	15,269,586
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		14,779,132	15,269,586
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	13	1,800,000	1,800,000
Rezerva ligjore		179,486	179,486
Fitime/(humbje) të mbartura		499,989	41,238
Fitimi i ushtrimit		196,060	458,751
Total kapitali		2,675,535	2,479,475
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		17,454,667	17,749,061

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	22,802,417	22,640,100
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	(7,181)	(81,854)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(3,500,844)	(2,175,847)
1) Sherbime nga te trete	16	(1,820,203)	(1,457,156)
2) Të tjera shpenzime	17	(1,680,641)	(718,691)
Shpenzime të personelit	18	(18,895,760)	(19,683,549)
1) Paga dhe shpërblime		(18,192,047)	(18,852,448)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(703,713)	(831,101)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	19	(156,209)	(102,230)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(10,000)	(48,376)
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		232,423	548,244
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	21	(36,363)	(89,493)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(36,363)	(89,493)
Fitimi/humbja e vitit		196,060	458,751
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin			-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		196,060	458,751

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Metro_Polis Shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Fitim/(humbja) e pashpërndara	Fitim/(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2019	1,800,000	179,486	-	41,238	2,020,724
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	458,751	458,751
Transferim ne fitime te mbartura	-	-	41,238	(41,238)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	1,800,000	179,486	41,238	458,751	2,479,475
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	196,060	196,060
Transferim ne fitime te mbartura	-	-	458,751	(458,751)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	1,800,000	179,486	499,989	196,060	2,675,535

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i shoqërisë "Metro_Polis " Shpk më 25 Mars 2021 dhe janë firmosur si më poshtë.

Z. Besnik Aliaj
Administrator

Mazars shpk
Mazars shpk
Hartues PF

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	196,060	458,751
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	7,180	81,856
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	36,363	89,493
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	156,209	102,230
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	4,632,585	8,639,771
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(961,670)	(4,856,140)
Rritje/(rënie) në detyrime të tjera	434,853	(2,758,637)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	4,501,580	1,757,324
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,332,140)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,332,140)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	-	(3,265,273)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	(3,265,273)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,169,440	(1,507,949)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4,623,595	6,213,400
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(7,180)	(81,856)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	6,785,855	4,623,595

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "METRO_POLIS" sh.p.k. është themeluar më 29.05.2007 dhe regjistruar më 23.10.2007 pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223005V sipas Vendimit Nr.38596 date 18.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është:

Studio projektimesh dhe konsulencë në keto kategori; masterplane-studime e plane rajonale urbanistike. Plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara-Qytete. Studime pjesore urbanistike. Projekte objekte civile-industriale-turistike deri në 5 kate etj.

Kaptali themeltar është 1,800,000 lekë.

Kohëzgjatja e veprimtarisë është e pa kufizuar.

Selia e shoqërisë është: Autostrada Tiranë-Durrës Km 5 Kashar Tiranë.

Administrator është Z. Besnik Aliaj.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara kërkon nga drejtuesit të ushtrorë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet e pasqyrave financiare.

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuarat të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumni i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

2.6. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/ LEK	123.7	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria në fillim regjistron aktivet dhe detyrimet financiare me vlerën e tyre të drejtë.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Çdo interes në transferimin e aktiveve financiare që është krijuar ose mbajtur nga shoqëria është njohur si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit per efekt fiskal për vitin aktual janë si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Mjete transporti	20%
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iii. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

3.7 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	6,674,663	4,446,498
Mjete monetare në arkë	111,192	177,097
	6,785,855	4,623,595

5. Llogari të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme	5,934,349	10,530,571
	5,934,349	10,530,571

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Tatim mbi fitimin	2,215,868	2,252,231
	2,215,868	2,252,231

Metro_Polis Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

7. Aktive Afatgjata Materiale

	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	-	604,841	820,944	1,425,785
Shtesa	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	-	604,841	820,944	1,425,785
Shtesa	2,332,140	-	-	2,332,140
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	2,332,140	604,841	820,944	3,757,925
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	-	424,983	555,908	980,891
Amortizimi i vitit	-	35,971	66,259	102,230
Gjëndja më 31 Dhjetor 2019	-	460,954	622,167	1,083,121
Amortizimi i vitit	77,738	28,777	49,694	156,209
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	77,738	489,731	671,861	1,239,330
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	-	179,858	265,036	444,894
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	-	143,887	198,777	342,664
Gjëndja më 31 Dhjetor 2020	2,254,402	115,110	149,083	2,518,595

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të pagueshme tregtare	3,858,106	3,876,240
	3,858,106	3,876,240

9. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj paleve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve	6,480,085	9,480,085
	6,480,085	9,480,085

10. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Sigurime Shëndetësore dhe Shoqërore	110,093	102,325
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	252,769	237,947
TVSH	1,267,343	1,265,731
	1,630,205	1,606,003

11. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të ardhurat e shtyra	2,068,625	-
	2,068,625	-

12. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe të tretëve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të pagueshme ndaj punonjësve	262,111	307,258
Te tjere debitorë/kreditorë	480,000	-
Totali	742,111	307,258

13. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 1,800,000 lekë.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 196.060 lekë përfaqeson fitimin e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

14. Të ardhura

Shoqëria gjatë vitit 2020 ka realizuar të ardhura nga aktiviteti i saj kryesor .

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22,802,417	22,640,100
	22,802,417	22,640,100

15. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitim nga këmbimet valutore	-	-
Humbje nga këmbimet e llogarive tregtare	(7,181)	(81,854)
	(7,181)	(81,854)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	31 dhjetor 2020
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	22,802,417
Sipas Kontabilitetit	22,802,417
Diferenca	-

16. Shërbime nga të tretët

Shërbimet nga të tretët detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shërbime nga të tretët (Nënkontrakte)	1,820,203	1,457,156
Totali	1,820,203	1,457,156

17. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shërbime printimi	490,961	308,665
Shpenzime të tjera	526,529	1,795
Shpenzime transpoti	97,460	83,070
Blerje të ndryshme, kancelari etj	102,120	38,150
Dieta	202,800	14,566
Shpenzime qeraje	149,119	147,797
Taksa të ndryshme	74,500	67,000
Komisione bankare	36,912	28,913
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	240	28,735
	1,680,641	718,691

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Paga dhe shpërblime	18,192,047	18,852,448
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	703,713	831,101
	18,895,760	19,683,549

19. Shpenzime amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime amortizimi	156,209	102,230
	156,209	102,230

20. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Gjoba dhe dëmshpërblime	10,000	48,376
	10,000	48,376

21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i Tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2019: 15%). Formularët e deklarimit të Tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore. Legjislacioni Tatimor dhe Ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Fitim i vitit para tatimit	232,423	548,244
Shpenzime të pazbritshme	10,000	48,376
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	10,000	48,376
Fitimi fiskal para tatimit	242,423	596,620
Tatimi mbi fitimin	(36,363)	(89,493)
Fitimi neto	196,060	458,751

22. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë Çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

23. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare